





INICIATIVA KOSOVARE PËR STABILITET  
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE



# Siguria & Shëndeti në Punë

## VDEKJET E HESHTURA

Gjatë vitit 2018, në Kosovë kanë humbur jetën 22 punëtorë në vendet e tyre të punës dhe qindra të tjerë kanë pësuar lëndime. Regjioni i Prishtinës me mbi 200 mijë banorë dhe 2,632 ndërmarrje të regjistruara zë vendin e parë në krahasim me regjionet e tjera. Për këtë arsye përfshinë numrin më të madh të aksidenteve me fatalitet në vendin e punës.



Pjesën më të madhe të aksidenteve me fatalitet në Kosovë gjatë viteve 2017-2018, dukshëm e zë sektori i ndërtimtarisë, me 76 për qind e fataliteteve në vend të punës. Supozohet që mes 10 deri në 15 për qind e të punësuarve, formal e jo formal, të jenë në sektorin e ndërtimtarisë. Edhe në vitin 2018, 58 për qind e fataliteteve në vend të punës i takojnë gjithashtu sektorit të ndërtimtarisë. Ndërtimtaria në sektorin privat mbetet punëdhënësi më i madh në Kosovë me 839 biznese të regjistruara, pas tregtisë, prodhimit, bujqësisë e pylltarisë si dhe akomodimit e aktiviteteve të shërbimeve me ushqim.




Në periudhën 10 vjeçare, viti 2007 prinë me shkallën më të ulët të vdekshmërisë me 1.71 për qind, ndërsa viti 2012 ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë me 6.38 për qind. Në vitin 2017 shkalla e vdekshmërisë përsëri shënon ngritje dhe arrin përqindjen 4.53 dhe as në vitin 2018, fatkeqësisht nuk ka ulje të shkallës së vdekshmërisë.



Iniciativa Kosovare për Stabilitet në raportin e fundit “Vdekjet e Heshtura”, ka gjetur se një nga problemet që lidhet me vdekjet në vendin e punës është edhe fshehja e tyre nga vëmendja e opinionit publik. Përderisa shumë lëndime në vendin e punës nuk raportohen, në anën tjetër ka një tendencë të vazhdueshme që edhe rastet e vdekjeve në vendin e punës tentojnë të mbahen të fshehura nga institucionet e rendit. IKS ka identifikuar 3 aspekte të brishta që ndikojnë në heshtjen e këtyre vdekjeve: Ambienti socio-ekonomik, Ambienti ligjor si dhe Transparenca.

Pse fshehën vdekjet në Kosovë?



Katërshja fatale 2017



Fatalitet nga rrezimi



Fatalitet nga dëmi elektrik



Fatalitet nga goditjet e papritura




Fatalitet nga makineria

Janë të ndryshme shkaqet e aksidenteve me fatalitet në punë, dhe zakonisht rastet klasifikohen sipas mënyrës së aksidentit. Organizata për Siguri dhe Shëndet në Punë - OSHA, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kategorizojnë këto aksidente në katër sosh. Duke e parë që pothuajse të gjitha mënyrat e aksidenteve bëjnë pjesë në njëërën nga katër llojet, IKS ka zgjedhur të përdorë “katërshen fatale” si klasifikim të aksidenteve me fatalitet në vendin e punës. Nga secila kategori e 4-shës fatale, IKS ka paraqitur ecurinë e rasteve si në tabelën në vijim.

Si Ligji i Punës ashtu edhe ai për Sigurisë dhe Shëndetit në punë gjejnë pak zbatim në sektorin privat. Përkundër shkëlqeve të shumta që bëhen në zbatimin e ligjit të punës, institucionet si Policia, Prokuroria, Inspektorati i Punës, Sindikata etj., ende nuk janë duke dhënë shenja të mjaftueshme serioziteti në parandalimin e kësaj dukurie. Prokuroria e shtetit për vitet 2017 dhe 2018 ka marrë në shqyrtim gjithsej 26 raste me 27 persona të akuzuar. Nga këto vetëm 17 raste janë zgjidhur, kurse pa zgjidhje kanë mbetur 9 raste. Ndërsa, bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vitin 2017, gjykatat kanë pasur në punë vetëm 43 lëndë, (përkatësisht vepra penale, të cilat lidhën me marrëdhënien e punës). Vetëm 5 lëndë që kanë pasur të bëjnë me sigurimet shoqërore, kanë qenë në proces shqyrtimi gjatë vitit 2017 nga të gjitha gjykatat, të të gjitha niveleve.


Lloji i rastit	Viti	Gjoha e shqiptuar nga IP	Rasti në Prokurori/Gjykatë
Fatalitet nga rreziku elektrik	2017	Po/ “Cënim i detyrimeve të përgjithshme të Punëdhënësit” Gjoha nuk u pagua nga Punëdhënësi	Lënda vazhdon të jetë në Gjykatë (padi e ngritur nga familja)
Fatalitet nga makineria	2017	Jo/nuk është cilësuar si shkelje nga IP pasi punëtori kishte gjetur vdekjen deri sa po punonte vullnetarisht gjatë një dite jo pune	Padi civile e ngritur nga familja / Rasti në prokurori
Fatalitet nga rrezimi	2015	Po/Mossigurim i kushteve të punës	Rasti i përfunduar/ka vendim gjyqësor
Fatalitet nga goditja	2017	Jo / IP ka vlerësuar se rasti është jashtë kompetencave të IP-së pasi punëdhënësi akterë jobiznesor dhe punëtori pa kontratë pune	Rasti në prokurori/në pritje të shqyrtimit



# AKSIDENTET ME FATALITET NË VENDIN E PUNËS

## HAPI 1

Në rastet kur ndodhë aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, Punëdhënësi është i detyruar të lajmërojë menjëherë:



Ligji për Shëndet dhe Siguri në Punë, Neni 23 paragrafi 1: Në rastet kur ka ndodhur aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës.

## HAPI 2

Inspektorati do t'i marrë masat adekuate në pajtim me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë nr. 04/L-161 për shkeljet e konstatuara në rastin ku ka ndodhur aksidenti me IP në vendin ku ka ndodhur aksidenti me fatalitet urdhëron me vendim:

- ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e rrezikut;
- urdhëron ndalimin e përkohshëm të procesit të punës

Nëse dyshohet se ekzistojnë elemente të veprës penale, Policia dhe Inspektorati i Punës, bëjnë kallëzim penal në prokurori.

Ligji për Shëndet dhe Siguri në Punë, Neni 23 paragrafi 2: Për aksidentet në punë, inspektori i punës detyrohet të bëjë procesverbal me shkrim me të cilin konstaton gjendjen faktike në kohën kur ka ndodhur aksidenti.

Ligji për Shëndet dhe Siguri në Punë, Neni 23 paragrafi 4: Inspektori i punës urdhëron me vendim ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e rrezikut, dhe nëse ka fakte të pamohueshme se kushtet e punës paraqesin rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve, urdhëron ndalimin e përkohshëm të procesit të punës në atë subjekt punues, nësi të subjektit punues ose makinë punuese.

## HAPI 3

### PROKURORIA

Nëse konstaton se ka elemente të veprës penale, iniciacioni procedurë penale sipas nentit 6 dhe 104 të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123.

Ngritë aktakuzë sipas nentit 241 të Kodit të Procedurës Penale

Pas procesit të gjykmrit dhe gjykata vendosë.

- Në aktgjykim gjykata mund të udhëzojë që për kompensimin e dëmit
- çështja të ndjeket me procedurë civile.

Kodi Penal, Neni 367 paragrafi 2: Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë reagon jetën e njëzëve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dëmohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

## HAPI 4

### KOMPENSIMI PËR FAMILJARËT E VIKTIMËS

Përmasë padisë civile nga pala e dëmtuar.

Gjykata vendos pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve:

- Kontrata e punës
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212
- Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë nr. 04/L-161
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077

Kodi i Procedurës Penale, Neni 6 - Fillimi i procedurës penale

1. Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83.
2. Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale
3. Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetar, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuar.



# Politikat Sociale në Interes të Gruas


---

Nëntëmbëdhjetë vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, gruaja vazhdon të jetë e diskriminuar. Vetëm 12 për qind e grave janë të punësuara, krahasuar me 46,6 për qind të burrave. Në këtë punësim të ulët të gruas, përveç shumë faktorëve tjerë, ka ndikuar edhe pushimi i lehonisë që është përcaktuar në Ligjin e Punës. Ky ligj ishte bërë me qëllim të përmirësimit të kushteve për lehonat duke e rritur pushimin nga 6 muaj sa ishte deri në vitin 2010 në 12 muaj. Përtej kohëzgjatjes së pushimit, ligji pati ndikime negative në punësim të grave, pasi shteti ia la bizneseve barrën kompensimit të lehonave. Ngarkimi i biznesit për të bërë pagesën e pushimit të lehonisë, po ndikon që këta të fundit të mos punësojnë gra të reja.

Kanë kaluar 8 vjet që kur është miratuar ligji, ndërkohë në vazhdimësi kishte debate nëse duhet të ndryshohet mënyra e kompensimit të pushimit të lehonisë dhe kohëzgjatja e tij. Debati ka marrë hov të madh gjatë vitit 2018, kur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vendosi që ta ndryshojë këtë ligj. Gjatë këtij viti janë dhënë propozime. Iniciativa Kosovare për Stabilitet, ka propozuar që gjashtë muajt e parë, nëna të paguhet nga buxheti i shtetit me 70 për qind të pagës bazë, me një tavan (kufizim) prej 1 mijë euro. Ndërkaq, pjesa e dytë e pushimit prej tre muajsh të jetë pushim prindëror që mund t'i takoj cilit do prej prindërve, varësisht marrëveshjes që bëjnë. Kompensimi për këtë periudhë në rast se e merr nëna do të jetë pa pagesë, ndërsa nëse e merr babai do të kompensohet nga qeveria me 50 për qind të pagës mesatare.

Propozimi i IKS për këtë lloj kompensimi është kalimtar. Zgjidhja afatgjate është themelimi i Fondit për Mbrojtje Sociale, i cili do të duhej të mbushej me participim të qytetarëve.

Rritja e punësimit të gruas, duhet të jetë një prej çështjeve më të rëndësishme për shtetin. Për të kaluar këtë dilemë, qeveria duhet të krijoj politika dhe legjislacion të veçantë, në interes të gruas dhe familjes. Vendet e tjera barrën e kompensimit të lehonave ia kanë lënë shtetit. Në Austri, përqindja e grave aktive në fuqinë punëtore është 71 për qind. Numri i ditëve të pushimit të lehonisë është 112 ditë me pagesë. Përqindja e pagës së paguar është 100 për qind, nga qeveria. Në Kroaci, 58 për qind e grave janë të përfshira në fuqinë punëtore. Ato kanë 208 ditë të pushimit të lehonisë me pagesë. Shuma e pagës së paguar është 100 për qind nga qeveria. Në shtetin e Gjermanisë 72 për qind e grave janë aktive në fuqinë punëtore. Numri i ditëve të pushimit të lehonisë është 98 ditë. Përqindja e pagës është 100 për qind dhe paguhet nga punëdhënësi dhe qeveria.



## Neni 7 - Pushimi i lehonisë dhe kompensimi i rrogave

Të punësuarit: Gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë të pagueshme nga buxheti me kompensim prej 70% të rrogës bazë, me tavan të aplikueshëm të 1000 EURO -

# 6 muaj

Shërbyes civil (plus trendi i rritjes vjetore 10%)	273 persona
Sektori publik (plus trendi i rritjes vjetore 10%)	603 persona
Sektori privat (i llogaritur me 30% e lindjeve)	9,000 persona
Gjithsejt persona	9,876 persona

Pagesa 70% e pagës baze e llogaritur sipas pagës mesatare x 6 muaj = 370 x 6 muaj



## Pushimi prindëror për babain

Pagesa 70% e pages baze 242* 3 muaj	726 €
Kosto - Shërbyes civil	198,198 €
Kosto -Sektori publik	473,337 €
Kosto -Sektori privat	6,534,000 €
Gjithsejt	7,205,535 € <sup>1</sup>



## Neni 17 - Mungesa nga puna për përkujdesje të veçantë për fëmijën (këto janë raste zakonisht të rralla)

Personat me aftësi të kufizuara që lindin	200
50% e pagës mesatare x 9 muaj	264 €
Për 12 muaj	81 €
Gjithsejt	16,200 €



Tre (3) muajt në vijim, pushimi prindëror (babai) paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim prej shtatëdhjetë për qind (50% të pagës mesatare)

# 3 muaj

Të punësuar	Përfituesit
Shërbyes civil	273 persona
Sektori privat	603 persona
Sektori publik	9,000 persona
Gjithsejt	9,876 persona

## Neni 9 - Pushimi i lehonisë në rast të vdekjes së foshnjës

Shërbyes Civil & Sektori Publik & Sektori Privat	Përfituesit
Të punësuar	161 persona
Pagesa 70% e pagës bazë 370x1.5 muaj (45 dite) x 161 përfitues =	555
Gjithsejt	89,355 <sup>2</sup>

## Neni 19 -Ndihma në para të gatshme për gra të papuna

Lindje gjatë vitit 2017	19,949
Ndihma në para	100 €
6 muaj	6
Gjithsejt	11,969,640 €



Lindje gjatë vitit 2017	30,025
Nëna që kanë lindur binjak e më shumë fëmijë	675
Lehona sipas alternativës së IKS	9,876
Gjithsejt	19,474 <sup>3</sup>



<sup>1</sup> Burimi: Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017

<sup>2</sup> Burimi: Statistikat e lindjeve ne Kosove, ASK

<sup>3</sup> Burimi: Vlerësimi Popullsia e Kosovës 2017

# Sa mendojnë institucionet për të moshuarit?

73 për qind e të moshuarve varen nga mbështetja familjare për të mbuluar nevojat e tyre elementare.

Pensionistët në Kosovë janë shtresa më e varfër e shoqërisë. Standardi i jetesës së tyre është rezultat

direkt i pensioneve të vogla, varfërisë së përhapur shumë dhe i varësisë nga familjet e tyre.

Në anën tjetër pamundësia për t'u siguruar pranë kompanive private shëndetësore, mungesa e qasjes në barna e materiale të tjera mjekësore falas, e vendosin pensionistin në pozitë të pa lakmueshme. Shumica e pleqve në Kosovë jetojnë në bashkësi. Sipas të dhënave të nxjerra nga raporti "Mos u Plaksh", i publikuar nga IKS, del se 79.8 për qind e pensionistëve përkujdesjen e marrin nga familja, pasi që të ardhurat e tyre nga pensionet nuk garantojnë as minimumin e mirëqenies sociale. Përveç kësaj, ata ankohen edhe për mungesë të aktiviteteve të organizuara nga institucionet komunale.

Një përqindje e madhe e personave të moshuar vlerësojnë se institucionet shtetërore nuk ia kanë dalë t'i përmbushin nevojat e tyre. 69 për qind e tyre kanë deklaruar se shteti ka dështuar në kujdesin për ta. Një pjesë e madhe e të moshuarve mendojnë se shoqëria është ajo që duhet të jetë më aktive me punë vullnetare në ndihmë/përkrahje për ta. Përveç kësaj, diskriminimi gjinor është i pranishëm sa i përket pasurisë kapitale dhe materiale. Gratë e moshuara rrallëherë janë pronare të shtëpive të tyre që i bën veçanërisht të cenueshme ndaj abuzimit dhe varfërisë ekstreme. Prej grave të anketuara, vetëm 11 për qind janë pronare apo pjesërisht pronare të pronës në të cilën jetojnë. Edhe kur mbesin të veja, vetëm 25 për qind prej tyre mbesin pronare. Të ardhurat e pensioneve sipas 64 për qind të moshuarve nuk u garantojnë as minimumin e mirëqenies sociale.

91 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se blejnë barna të listës esenciale.

77 për qind e të moshuarve mendojnë që shteti ka përgjegjësi për të siguruar mbrojtje adekuate për të moshuarit.

50 për qind e të moshuarve kanë të ardhura mujore prej vetëm 71-100 euro në muaj.

# Sistemi i Mbrojtjes Sociale

---

Qeveria e Kosovës akoma nuk ka arritur të ndërtojë një sistem bazik të mbrojtjes sociale në mënyrë që pensionistët të kenë një jetë të dinjitetshme dhe kështu do të ju mundësonte qytetarëve të marrin shërbimet e nevojshme. Raportet e fundit të Iniciativës Kosovare për Stabilitet, dëshmojnë se ekziston një pabarazi e theksuar mes qytetarëve, si pasojë e mungesës së një sistemi të tillë. Në raportin “Mos u Plaksh” thuhet se kur është fjala për të moshuar përgjegjësi të caktuara, të cilat në kushte normale do të duhej t’i takonin shtetit, i ka marrë familja.

Në anën tjetër, raporti “Vdekjet e Heshtura”, argumenton se qytetarët pranojnë të punojnë në kushte të pa përshtatshme si pasojë e varfërisë së madhe. Kështu, nevoja për të krijuar një sistem të mbrojtjes sociale, nga i cili do të mund të përfitonin kategori të ndryshme të shoqërisë, si: të moshuarit, punonjësit e sektorit privat, veçanërisht gratë, është shumë e madhe.

Kosova ka një sistem pensional, i cili përbëhet nga tri shtylla kryesore. E para përfshinë pensionet bazë, ku secili person nga moshë 65 vjeçare e tutje ka të drejtë të ketë pensionin e pleqërisë. Posa, nga kjo skemë përfitojnë pensione edhe personat me nevoja të veçanta, invalidët e luftës, pensionet e parakohshme, etj. Shtylla e dytë përbëhet nga kursimet e detyrueshme nga secili punëtor, nga i cili përbëhet Fondi i Trustit. Si dhe shtylla e tretë, përfshinë kursime vullnetare shtesë. Këto llogari licencohen dhe rregullohen nga Banka Qendrore e Kosovës. Në një studim të IKS, thuhet se sistemi është i rregulluar mirë në pikëpamje gjithëpërfshirës të popullsisë, por çështja është, nëse shumat që marrin nga këto pensione, mund apo jo t’i garantojnë këtyre kategorive shoqërore një minimum të mirëqenies.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 26 mijë familje marrin ndihma sociale. Kriteret për të përfituar nga këto skema janë përcaktuar me ligj, ku bëjnë pjesë; personat mbi moshën 18 vjeçare, por që kanë nevoja të veçanta, kujdestarët e përhershëm të tyre, prindërit vetëshqyrtues etj. Të drejtë kanë edhe familjet me një anëtar të aftë për punë që plotëson dy kriteret: të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare ose që kanë përkujdesje të përhershme për një jetim nën moshën 15 vjeçare. Për vitin 2018, buxheti për këto skema ka qenë 31.4 milion euro.

Në sistemin e mbrojtjes sociale, hallka më e dobët është sigurimi shëndetësor. Kosova nuk ka një sistem sigurimi shëndetësor, i cili do të ishte gjithëpërfshirës. Zbatimi i Ligjit në fuqi vazhdimisht proklamohet nga qeveritarët. Në raportin “Vdekjet e Heshtura”, të IKS, del se asnjë nga personat që kanë humbur jetën në vitet 2017 dhe 2018 nuk ka pasur sigurim shëndetësor. Mungesa e tij, është shkelje e të drejtave të njeriut. Më të ekspozuarit ndaj këtyre shkeljeve janë ata që janë në marrëdhënie pune, me theks të veçantë të atyre në sektorin privat.



# Politikat Sociale

---

Çështjet sociale rrallë herë i hasim në diskursin e partive politike. Këto tema vëmendje marrin vetëm në kohë fushatash. Pothuajse në të gjitha programet e partive politike punësimi dhe zhvillimi ekonomik përmenden si zgjidhje e vetme për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Si rrjedhojë, ka shumë pak diskutime për politikat sociale dhe ato zakonisht shihen si të rëndësishme dytësore kundrejt temave të mëdha politike si: liberalizimi i vizave, lufta kundër korrupsionit, demarkacioni etj, të cilat kanë qenë top prioritete të partive politike në zgjedhjet e parakohshme nacionale në vitin 2017. Hapësira që ju është dhënë nga mediat këtyre temave e kanë lënë nën hije çdo nismë apo proces tjetër.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS, në kuadër të hulumtimit “Përfshirja sociale në programet e partive politike”, ka analizuar programet zgjedhore të tri partive/koalicioneve më të mëdha në zgjedhjet nacionale të vitit 2017. Në bazë të gjetjeve të IKS, çështjet sociale nuk janë prioritet për partitë politike.

Nuk ka një plan funksional dhe të jetësueshëm për t'u marrë me çështjet që i prekin kategoritë më të cënueshme. Në përgjithësi, analiza tregon se nuk mund të priten shumë përmirësim nga partitë politike ekzistuese për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive nevojave të kategorive sociale, si dhe për të ndërtuar një rrjetë sigurie dhe mbështetjeje rreth tyre. Zotimet politike të të gjitha partive politike/koalicioneve të monitoruara gjatë programit zgjedhor në të shumtën e rasteve nuk janë të konceptualizuara mirë, ofrojnë shumë pak inovacion, dhe/ose nuk janë të zbatueshme në Kosovë. Mediat dhe shoqëria civile gjithashtu kanë qenë mjaft pasive sa u përket politikave sociale dhe mirëqenies së grupeve më të cënueshme. Janë vetëm disa Organizata të Shoqërisë Civile, të cilat u kanë kushtuar vëmendje këtyre kategorive. Koalicioni për Drejtësi Sociale, është partneriteti i vetëm ndër sektorial që synon drejtësi më të madhe sociale, i cili ka arritur ta grumbullojë një masë të madhe organizatash të cilat së bashku u japin kontribut këtyre çështjeve. Mediat, sikurse OSHC-të, kryesisht janë peng i përçimit të informacioneve protokollare dhe nuk arrijnë t'i vokalizojnë nevojat dhe prioritetet e atyre më në nevojë dhe më të pafat. Në vend të kërkimit të drejtësisë më të madhe sociale, mediat u shkojnë pas partive politike dhe në të shumtën e kohës futen në gracka të politikës së lartë, duke u lënë pak hapësirë telasheve ditore dhe më nevojtarëve.

# Sa janë të nevojshme ndërhyrjet në sistemin pensional?

Në Kosovë sistemi pensional përbëhet nga disa skema pensionale si: pensionet bazike, kontribut dhënëse dhe vullnetare. Për sa i përket ndarjes gjinore të dhënat e fundit të ASK-së për vitin 2017, tregojnë se në Kosovë pensionin bazik e përfitojnë, 81 mijë e 253 gra dhe 41 mijë e 463 burra. Pra, janë gjithsej 122 mijë e 716 përfitues. Në anën tjetër, pensione kontribut pagues marrin 37 mijë e 326 burra dhe vetëm 5 mijë e 974 gra. Gjithsej 43 mijë e 300 përfitues. Nga të dhënat e IKS, del se rreth 10 mijë persona përfitojnë në mënyrë të paligjshme nga skema e pensioneve bazë.

Skemat pensionale janë mekanizma të cilat duhet të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme për të ruajtur standardin e jetesës së të moshuarve, mirëpo në Kosovë sistemi pensional shfaq një sërë mospërputhesh për sa i takon një numri komponentësh të tij. Duke qenë se reforma prek secilin qytetarë të Kosovës, atëherë duhet ndërmarr hapa konkret për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm pensional. MPMS, tashmë ka lansuar draftin fillestar të Koncept-Dokumentit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve. Reformat të cilat po synohen për përfituesit e pensioneve po bëhen në kohën kur të moshuarit ende nuk marrin pensione që i mbulojnë shpenzimet e tyre mujore. Gjithash-tu, testimi i të ardhurave nuk duhet të ndodh siç parashihet sepse është metodë që ka për qëllim vetëm vështirësimin e kriterëve për të marrë pensionin i cili garantohej me ligj. Në një hulumtim të realizuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), konstatohet se: pensionet aktuale nuk garantojnë një mirëqenie për pensionistët. Në raportin me temë "Hulumtimi i Perceptimeve dhe Qëndrimeve të Qytetarëve për shtetin social", 65.9 për qind e të anketuarve deklarohen se standardit i jetës së pensionistëve në Kosovë është shumë i keq. Sipas të dhënave të IKS, mbi 49.9 për qind thonë se një pension mujor për t'i mbuluar nevojat bazike duhet të jetë prej 200 deri në 300 euro.

Procesi i reformave, duhet të synojë përmirësimin e shërbimeve/beneficioneve për të moshuarit, zvogëlimin e burokracisë si dhe largimin e keqpërdoruesve potencial të skemës. Reforma nuk duhet ta ngarkojë pensionistin duke e detyruar të dëshmojë së është gjallë me prezencë personale në zyrat e ministrisë, mirëpo duhet të sofistikoj sistemin që automatikisht t'i largoj të vdekurit nga lista. MPMS, duhet të marrë përgjegjësi që të siguroj një sistem të shëndosh social i cili është i sajuar për të ju përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të kategorive të cenueshme.

Çdo përpjekje për t'i formuluar politikat pensionale me synim të zvogëlimit të shpenzimeve buxhetore dhe jo me qëllim të rritjes së mbrojtjes dhe gjithë përfshirjes së sistemit, do të ketë efekte të pariparueshme për brezin aktual dhe për brezat e ardhshëm. Një ndërhyrje e tillë, thellon parbarazinë sociale sidomos në baza gjinore.

Andaj, politikat sociale me fokus pensionet që aktualisht aplikohen ndikojnë në gjendjen ekonomike të të moshuarve. Reformimi i pensionit bazik që iu garanton nga 75 euro secilit të moshuar mund të shkaktoj varfëri gjatë periudhës së tyre të pensionit. Nëse sistemi ndryshon siç propozon ministria, që të hiqet pensioni bazë, atëherë saktësisht 81 mijë e 253 gra përfituese të kësaj skeme, mbesin pa të ardhura. Shto kësaj edhe 41 mijë e 463 burra, atëherë mund të krijohen probleme sociale të pamendueshme. Në anën tjetër një pjesë e madhe e moshës së tretë, do të mbeteshin në varësi të familjeve. Sistemi duhet të reformohet në pikëpamje të menaxhimit të tij, pra të pamundësohet keqpërdorimi i sistemit dhe të mos përfitohet në mënyrë të paligjshme.